



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.11

27 shkurt

2012

P Ë R M B A J T J A

	Faqe	
Vendim i KM nr. 44, datë 26.1.2012	Për miratimin e Marrëveshjes së Projektit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, për dhënien e ndihmës financiare për projektin “Furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizime në Lezhë dhe Shëngjin”.....	477
Vendim i KM nr. 48, datë 26.1.2012	Për kalimin e pronës “Moli i Radhimës, Orikum”, Vlorë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Brendshme, për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe për një ndryshim në vendimin nr. 250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”.....	488
Vendim i KM nr. 49, datë 26.1.2012	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 602, datë 24.8.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e mënyrës së përdorimit të fondeve kundërparti, të mbledhura nga grandet japoneze për sektorin e bujqësisë dhe të ushqimit”, të ndryshuar.....	489
Vendim i KM nr. 50, datë 26.1.2012	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Rrajcë të qarkut të Elbasanit.....	490
Vendim i KM nr. 62, datë 1.2.2012	Për mënyrën e funksionimit të Komisionit të Çmimit të Barnave.....	491
Udhëzim i MPPT nr. 3, datë 31.1.2012	Për disa shtesa në udhëzimin nr. 20, datë 10.10.2007 “Për modelet e licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, të ndryshuar.....	493
Urdhër i MASH nr. 34, datë 31.1.2012	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë “Master profesional” në “Administrim publik”, pranë shkollës së lartë universitare jopublike “Gjon Buzuku”, Shkodër.....	495

Urdhër i MASH nr. 37, datë 2.2.2012	Për riorganizimin e njësive kryesore të shkollës së lartë universitare private “Medikadent”.....	496
Urdhër i MASH nr. 38, datë 2.2.2012	Për hapjen e programeve të reja të studimit pranë institucionit privat “Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës”.....	497
Vendim i ERE nr. 7, datë 24.1.2012	Për miratimin e marrëveshjes së transmetimit të energjisë elektrike me nr. 4168 prot., datë 30.12.2011 midis OST sh.a. dhe “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k.....	498
Vendim i ERE nr. 8, datë 24.1.2012	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Hydro Salillari” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	499
Vendim i ERE nr. 9, datë 24.1.2012	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Hydro Salillari” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues për “Hec Vertop” si burim i rinovueshëm energjie.....	500
Vendim i ERE nr. 10, datë 25.1.2012	Mbi ankimin administrativ të “CEZ shpërndarje” sh.a., në lidhje me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 147, datë 7.12.2011 “Për përcaktimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore” dhe vendimin nr. 148, datë 7.12.2011 “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën e tretë rregullatore”.....	501
Vendim i ERE nr. 11, datë 6.2.2012	Për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike me seri PV10K, nr. 104, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 51, datë 5.7.2010, për shoqërinë “Wenerg” sh.a.....	502
Vendim i ERE nr. 12, datë 6.2.2012	Për licencimin e shoqërisë “Snow Energy” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Koka 1”.....	503
Vendim i ERE nr. 13, datë 6.2.2012	Për licencimin e shoqërisë “Snow Energy” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	504
Vendim i ERE nr. 14, datë 6.2.2012	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Hydro Power Plant of Korca” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et “Verba 1” dhe “Verba 2”.....	505
Vendim i ERE nr. 15, datë 6.2.2012	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Albania Power” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec Martanesh.....	506
Vendim i KKRT nr. 9, datë 27.1.2012	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “Tv kabllor KL-ED”.....	507
Vendim i KKRT nr. 10, datë 27.1.2012	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio AS”.....	507
Vendim i KKRT nr. 11, datë 27.1.2012	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Idea”.....	508
Vendim i KKRT nr. 13, datë 27.1.2012	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Bajram Curri”.....	508
Vendim i KKRT nr. 14, datë 27.1.2012	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Era”.....	509

VENDIM
Nr. 44, datë 26.1.2012

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË PROJEKTIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË KONFEDERATËS
ZVICERANE, PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR PROJEKTIN “FURNIZIMI
ME UJË TË PIJSHËM DHE KANALIZIME NË LEZHË DHE SHËNGJIN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së projektit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, për dhënie e ndihmës financiare për projektin “Furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizime në Lezhë dhe Shëngjin”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE PROJEKTI

**NDËRMJET QEVERISË SË KONFEDERATËS ZVICERANE DHE KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE
PËR PROJEKTIN “FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM DHE KANALIZIME NË LEZHË DHE
SHËNGJIN”**

Qeveria e Konfederatës Zvicerane, e përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financës,

duke iu referuar Marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin teknik, financiar dhe humanitar, lidhur dhe nënshkruar në Tiranë më 11 maj 2007 dhe ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me ligjin nr. 9801, më datë 13 shtator 2007;

me dëshirën për të forcuar këto marrëdhënie dhe bashkëpunimin e frytshëm midis dy vendeve;

me synim nxitjen e zhvillimit të mëtejshëm ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë;

duke vlerësuar angazhimin e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për të vazhduar reformat me qëllim që të vendoset ekonomia e tregut nën kushte demokratike;

duke pranuar se projekti është bazuar në analizat institucionale nga MACS GmbH, datuar në dhjetor 2009 dhe në studimin teknik të parafizibilitetit prej *Günter Wagner*, datuar në tetor 2010;

duke marrë parasysh dhënie e ndihmës financiare zvicerane për projektin “Furnizimi me ujë të pijshëm dhe i kanalizimeve në Lezhë dhe Shëngjin”,

kanë rënë dakord si më poshtë:



Neni 1 Përkufizime

Në këtë Marrëveshje projekti, përveç se kur konteksti kërkon ndryshe, termat në vijim do të kenë kuptimin si më poshtë:

- a) “Qeveria e Shqipërisë”, nënkupton Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë.
- b) “Qeveria Zvicerane” nënkupton Qeverinë e Konfederatës Zvicerane (Këshilli Federal Zviceran).
- c) “MF” nënkupton Ministrinë e Financës së Republikës së Shqipërisë.
- d) “MPPT” nënkupton Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit të Republikës së Shqipërisë.
- e) “SECO” nënkupton Sekretarin e Shtetit për Çështjet Ekonomike të Konfederatës Zvicerane.
- f) “Palët kontraktuese” nënkupton MF dhe SECO.
- g) “Marrëveshje kuadër” nënkupton Marrëveshjen midis Këshillit Federal Zviceran dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik, Financiar dhe Humanitar lidhur dhe nënshkruar më 11 maj 2007 dhe e ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me ligjin nr. 9801, e datës 13 shtator 2007.
- h) “Projekt” nënkupton projektin “Furnizimi me ujë të pijshëm dhe i kanalizimeve në Lezhë dhe Shëngjin”.
- i) “Marrëveshje projekti” nënkupton marrëveshjen midis palëve kontraktuese, e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese në lidhje me projektin në vazhdim referuar si MP.
- j) “Kontributi zviceran” nënkupton kontributin financiar të parimbursueshëm të dhënë nga SECO sipas kësaj MP.
- k) “KfW” nënkupton *German Kreditanstalt für Wiederaufbau* në Frankfurt, Gjermani.
- l) “Programi I i infrastrukturës bashkiake” nënkupton programin e financuar prej huas së KfW-së, kontributin financiar të ofruar nga Bashkimi Europian (BE) dhe kontributi zviceran për projektin, i cili formon një pjesë integrale të programit.
- m) “Marrëveshjet e huas dhe të financimit” nënkupton marrëveshjen e huas midis KfW-së dhe Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga MF dhe marrëveshjes së financimit midis MF dhe KfW, e nënshkruar nga të dy palët më 23.12.2010 në lidhje me zbatimin e Programit I të infrastrukturës bashkiake.
- n) “Marrëveshje e veçantë” nënkupton marrëveshjen midis KfW-së dhe Qeverisë së Shqipërisë, që plotëson marrëveshjet e huas dhe financimit, e nënshkruar më 23.12.2010.
- o) “Marrëveshje administrative” nënkupton marrëveshjen midis KfW dhe SECO për menaxhimin e kontributit zviceran.
- p) “PMU” nënkupton njësinë menaxhuese të projektit (NMP) e caktuar me detyrën e koordinimit dhe menaxhimit të këtij projekti dhe e vendosur brenda MPPT-së.
- q) “PEA” nënkupton agjencinë e zbatimit të projektit (AZP) për projektin (d.m.th. UK Lezhë).
- r) “Komiteti drejtues” nënkupton komitetin drejtues të ngritur për Programin I të infrastrukturës bashkiake.
- s) “Kontraktues” nënkupton kontraktues zviceran, të huaj dhe vendas të financuar nga ky kontribut.
- t) “Ekspertë të huaj” nënkupton ekspertë të huaj-konsulentë, ekspertë, furnizues-të autorizuar nga NMP ose AZP dhe financuar nën Programin I për infrastrukturën bashkiake për të realizuar projektin.

u) “Konsulent” nënkupton konsulentin e përgjithshëm të financuar nën marrëveshjet e huas dhe financimit.

v) “Pajisje” nënkupton *hard*-dhe programe kompjuterike të prokuruar nën këtë projekt.

w) “TVSH” nënkupton tatimin mbi vlerën e shtuar.

Neni 2

Objektivi dhe qëllimi i kontributit zviceran

2.1 Projekti “Furnizimi me ujë të pijshëm dhe i kanalizimeve në Lezhë dhe Shëngjin” është pjesë e një program më të gjerë, të quajtur “Infrastruktura bashkiake I”. Ky program trajton përmirësimin e situatës së furnizimit me ujë dhe të shkarkimit të ujërave të zeza në bashkitë e Gjirokastrës, Fierit, Lezhës dhe Sarandës.

2.2 Objektivi i përgjithshëm i kontributit zviceran është që të ndihmojë bashkinë e Lezhës për të siguruar një furnizim me ujë të pijshëm të vazhdueshëm dhe higjenik për popullsinë e saj me kosto të mbulueshme dhe me tarifa të përballueshme nga ana sociale, si edhe për të siguruar një zgjidhje të përshtatshme për higjienën nëpërmjet shkarkimit të ujërave të zeza.

2.3 Projekti synon të ndihmojë ndërmarrjen e ujit dhe të kanalizimeve të Lezhës për ta menaxhuar sistemin në mënyrë të sigurt dhe sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, duke përfshirë krijimin e procedurave të mira të mirëmbajtjes dhe të marrëdhënieve me klientin. Më specifikisht, objektivat kryesorë të projektit (shikoni kornizën logjike për referencë në aneksin 1) janë si më poshtë:

- i) Ofrimi i të njëjtit nivel shërbimi për furnizimin me ujë të pijshëm për një numër më të madh të klientëve të bashkisë Lezhë.
- ii) Sigurimi i furnizimit me ujë të pijshëm të besueshëm dhe të vazhdueshëm pa ndërprerje.
- iii) Ulje e kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes, si dhe ruajtja e përballueshmërisë për pagimin e tarifës së ujit të pijshëm, ndërkohë që sigurohet mbulimi i kostove dhe rritja e aftësisë së bashkisë për të vazhduar me rehabilitimin e sistemit të ujit.
- iv) Përmirësimi i cilësisë së ujit të pijshëm.
- v) Përmirësimi i marrëdhënieve me klientin dhe sensibilizimi i klientëve mbi mungesën dhe përdorimin e kujdesshëm të burimeve ujore.
- vi) Përgatitja e vendimeve për investime lidhur me kanalizimet e ujërave të zeza në bashkinë e Lezhës.

Këto objektiva do të arrihen përmes përdorimit më të mirë të kontributit zviceran, si dhe përmes fondeve që janë të disponueshme për bashkinë e Lezhës dhe Qeverinë e Shqipërisë sipas Programit I të infrastrukturës bashkiake.

2.4 Çdo ndryshim i madh në hartimin e projektit duhet të kërkojë pëlqimin paraprak të palëve kontraktuese dhe KfW. NMP dhe/ose AZP duhet të informojë KfW dhe SECO-n menjëherë, duke deklaruar arsyet, masat e planifikuara dhe pasojat e ndryshimit (duke përfshirë kostot totale). Zbatimi i masave të tilla mund të fillojë vetëm mbi bazat e planifikimit të rishikuar dhe me miratimin e KfW-së dhe SECO-s.

Neni 3

Shuma dhe përdorimi i kontributit

3.1 SECO ka rënë dakord që t’i japë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë një kontribut zviceran të parimbursueshëm në vlerën maksimale prej 10,520,000 (dhjetë milionë e pesëqind e njëzet mijë) eurosh për zbatimin e projektit. Kjo shumë përfshin fonde në shumën 520,000 euro për të mbuluar pagesat administrative të KfW-së dhe kostot për një auditim përfundimtar financiar të projektit. Pagesat jashtë kontributit do të përlllogariten në bazë të kostove efektive.



3.2 Të ardhurat e kontributit zviceran do të përdoren për financimet e mëposhtme:

a) Rehabilitimin dhe zëvendësimin e infrastrukturës ekzistuese (përafërsisht 83 km të tubacionit ekzistues për shpërndarjen e ujit, rreth 6 000 lidhje me sistemin e furnizimit me ujë dhe një rezervuar të ri uji);

b) Ndërtimin e seksioneve dhe lidhjeve të reja në rrjetin e ujit të pijshëm (përafërsisht 4 000 persona shtesë për t'u lidhur me rrjetin qendror të furnizimit me ujë);

c) Zëvendësimi i një pusi në fushën e puseve në Barbulloja;

d) Blerja dhe instalimi i pajisjeve të kontrollit të rrjetit të ujit të pijshëm dhe pajisjes për gjetjen e rrjedhjeve;

e) Masa të menjëhershme të rehabilitimit (rinovimi dhe zëvendësimi i tubacioneve) të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza;

f) Shërbime konsulence lidhur me investimin për zbatimin e Programit I të infrastrukturës bashkiake (bashkëfinancim me KfW);

g) Studimi i fizibilitetit i të gjithë sistemit të kanalizimeve që varen prej ndërmarrjes së ujit të bashkisë së Lezhës.

3.3 Kontributi zviceran nën MP njihet prej palëve kontraktuese si një pjesë integrale bashkëfinancuese e Programit I të infrastrukturës bashkiake, i cili është financuar nga KfW, BE dhe Qeveria Zvicerane.

3.4 Pajisja do të bëhet pronë e bashkisë së Lezhës. Asnjë nga të ardhurat e kontributit nuk do të përdoret për qëllime të tjera përveç se përmirësimin të infrastrukturës së ujit të pijshëm dhe funksionimit të sistemit të programit të përmendura në Programin I të infrastrukturës bashkiake.

3.5 Asnjë nga të ardhurat e kontributit nuk do të përdoren për të paguar ndonjë detyrim apo taksa, si për shembull TVSH-në, detyrimin doganor, detyrimin e importit, taksa, çfarëdo tarife apo ndonjë të tillë e imponuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë apo ndonjë entiteti të varur shtetëror.

3.6 Fondet për shpenzimet e paparashikuara, ashtu siç janë përcaktuar tek aneksi 3, mund të përdoren në rast të ndonjë shpenzimi të paparashikuar të lindur gjatë implementimit të projektit dhe për aktivitete në lidhje me projektin, të cilat çmohen si të nevojshme nga SECO për një përfundim të suksesshëm të projektit. Vendimi për përdorimin e pjesës zvicerane të fondeve për shpenzime të paparashikuara mbetet plotësisht sipas gjykimit të SECO-s.

3.7 Çdo pjesë e papërdorur e kontributit, që mbetet pas 31 dhjetorit të 2016, përkatësisht pas përfundimit të MP aktuale, sipas nenit 12 paragrafi 2 do të anulohet, vetëm nëse palët kontraktuese bien dakord ndryshe.

Neni 4

Kushtet e kontributit zviceran

4.1 Përveç kur kjo MP ka dispozita të veçanta, marrëveshja kuadër, marrëveshja administrative, marrëveshjet e huas dhe financimit, si dhe marrëveshja e veçantë do të drejtojnë zbatimin e projektit dhe përdorimin e kontributit zviceran. Kushtet e përcaktuara në këto Marrëveshje për zbatimin e projektit do të aplikohen, *mutatis mutandis*, ndaj kontributit zviceran të dhënë nëpërmjet MP. Në mënyrë të veçantë, palët kontraktuese do të sigurojnë kushtet e zbatimit të projektit sipas nenit 4 të marrëveshjes kuadër. Në rast të ndonjë mospërputhjeje midis këtyre marrëveshjeve dhe kësaj MP, kjo e fundit do të mbizotërojë.

4.2 Qeveria e Shqipërisë do t'u japë falas, vizat e nevojshme hyrëse ekspertëve të huaj të përfshirë në projekt, si dhe përjashtimin nga ndonjë detyrim doganor, taksa dhe detyrime të tjera të imponuara nga ligjet e Republikës së Shqipërisë apo të ndonjë entiteti të varur shtetëror, e

zbatueshme për të gjitha pagat, sendet personale dhe pajisjet e nevojshme për detyrat e tyre në këtë projekt.

4.3 MPPT dhe/ose MF do të lehtësojë importimin e përkohshëm dhe më pas rieksporimin nga Shqipëria të të gjitha pajisjeve nën pronësinë e ekspertëve të huaj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve të tyre.

4.4 Për të siguruar qëndrueshmërinë e investimit në periudhën afatgjatë, do të ofrohet asistencë teknike dhe masa për ngritjen e kapaciteteve në fushën e zhvillimit të korporatës, mbështetur nga Programi I i infrastrukturës bashkiake¹. Për këtë qëllim ndërmarrja do të përvetësojë menaxhimin mbi baza të performancës në mënyrë që të arrihen synimet e projektit, ashtu siç janë paraqitur në kuadrin logjik në aneksin 1. Pavarësisht këtyre synimeve kaq ambicioze, nuk do të jetë e mundur të arrihet mbulimi i plotë i kostove (duke përfshirë dhe amortizimin) pa marrë masa për të forcuar kapacitete menaxhuese të ndërmarrjes, si dhe një rritje të tarifave. Familjet e varfra mund të kenë nevojë për subvencione për t’iu bashkëngjitur kufirit të pranuar në nivel ndërkombëtar prej 5% të të ardhurave familjare për t’u shpenzuar për ujë dhe shërbimet e kanalizimeve. AZP-ja dhe bashkia janë të përkushtuara për të punuar për këto çështje.

4.5 Bashkia dhe ndërmarrja e ujit dhe kanalizimeve Lezhë ndërmarrin së bashku të gjitha masat e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e zonës me ujë të pijshëm në fushën e puseve në Barbulloja, kryesisht lidhur me zbatimin e zonave të mbrojtjes së ujit të pijshëm, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

4.6 Zbatimi i projektit është i kushtëzuar më tej me arritjet e shprehura në nenin 4 “Marrëveshjet e veçanta të zbatimit” sipas marrëveshjes së veçantë.

4.7 Në mënyrë që të sigurohet vizibiliteti i kontributit zviceran, të gjitha materialet e marrëdhënieve me publikun dhe të gjitha dokumentet e përgatitura nga konsulenti duhet të përfshijnë një referencë ku të shprehet fakti se Programi I i infrastrukturës bashkiake është bashkëfinancuar nga Qeveria Zvicerane dhe të pasqyrojnë logon e Qeverisë Zvicerane.

Neni 5

Organizimi i projektit dhe përgjegjësia

5.1 KfW do të ngarkohet drejtpërdrejt me menaxhimin dhe zbatimin e kontributit zviceran. Për këtë qëllim, SECO do të nënshkruajë një marrëveshje administrative me KfW-në. Kjo e fundit do të veprojë në emër të SECO-s brenda kornizës së marrëveshjes së përmendur dhe do të jetë përgjegjëse për monitorimin e projektit.

5.2 NMP, në varësi të MPPT, ka përgjegjësinë e përgjithshme për realizimin e projektit dhe duhet të marrë ose të bëjë që të merren të gjitha veprimet e nevojshme ose të përshtatshme për kryerjen e projektit. Për më tepër, duhet të ndjekë veprimet siç janë paraqitur në marrëveshjen e veçantë dhe duhet t’i raportojë komitetit drejtues.

5.3 AZP, UK Lezhë, është autoriteti përgjegjës për zbatimin në terren të projektit. Për më tepër:

- duhet t’u bëjë të disponueshme konsulentit dhe ekspertëve të huaj të gjitha skicat ekzistuese dhe të dhënat e projektit të infrastrukturës në fjalë;
- duhet t’u caktojë kohë të mjaftueshme inxhinierëve të saj për të punuar me ekspertët;

¹ Masat për të forcuar kapacitete e menaxhimit të ndërmarrjes së ujësjellës-kanalizime trajtojnë çështje të tilla si regjistrimin e asetëve, faturimin dhe kontabilitetin, menaxhimin e informacionit (GIS), rishikimin e procedurave të operimit dhe mirëmbajtjes, si dhe një numër veprimtarish që lidhen me përmirësimin e leximit të matësve të ujit të pijshëm dhe praktikave të faturimit. Duhet të merret parasysh edhe blerja e pajisjes për kalibrimin e matësve të ujit të pijshëm.



- duhet të sigurojë ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pajisjes së dërguar;
- duhet të marrë lejet dhe autorizimet e nevojshme për të lejuar kryerjen e punëve brenda kuadrit të projektit;
- duhet të raportojë te Komiteti Drejtues;
- në bashkëpunim me bashkinë, duhet të ndërmarrë fushata sensibilizuese për të promovuar përdorimin e kujdesshëm të burimeve të ujit të pijshëm dhe të trajtojë çështje të tilla si mbetjet në vendet publike dhe në mënyrë të veçantë kanalet dhe pusetat e hapura të ujërave të zeza.

5.4 Bashkia e Lezhës është pronarja e infrastrukturës. Bashkia, sipas mesazhit të drejtuar KfW-së dhe SECO-s më 22 tetor 2010, është e përkushtuar t'i kërkojë këshillit bashkiak të miratojë alokimin e një sasive vjetore prej 10.000 USD për rehabilitimin e masave të rrjeteve të ujit (referojuni aneksit 2). Ajo duhet të ndërmarrë ose përpiqet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të krijuar një mjedis të favorshëm për përmirësimin e performancës së ndërmarrjes së ujit dhe kanalizimeve të bashkisë. Ajo duhet të lehtësojë gjithashtu marrjen e të gjitha lejeve dhe autorizimet e nevojshme për të lejuar kryerjen e punëve brenda kuadrit të projektit. Ajo duhet të delegojë një përfaqësues në komitetin drejtues.

5.5 SECO është autoriteti përgjegjës në anën zvicerane dhe:

- do të japë një kontribut të parimbursueshëm siç është e përcaktuar në nenin 3;
- do të nënshkruajë një marrëveshje administrative me KfW-në për menaxhimin e kontributit zviceran;
- do të rezervojë të drejtën të rishikojë dhe të miratojë paketat e tenderit dhe procedurat e prokurimit për shërbimet e konsulencës, si dhe të japë letrat e moskundërshtimit për dokumentet e tenderit dhe raportet vlerësuese të tenderit për shërbimet e konsulencës nën këtë projekt në përputhje me marrëveshjen administrative;
- do të komentojë raportet e konsulentit;
- do të delegojë një përfaqësues në komitetin drejtues.

5.6 Një komitet drejtues do të ngrihet për të drejtuar dhe mbikëqyrur në mënyrë strategjike të gjithë Programin I e infrastrukturës bashkiake, si dhe për të trajtuar çështjet e politikës së korporatës. Komiteti drejtues do të përfshijë, përveç përfaqësuesve të përmendur në këtë nen, dy përfaqësues të KfW-së, si dhe të AZP-ve të tjera sipas Programit I të infrastrukturës bashkiake. Komiteti drejtues do të monitorojë në mënyrë strategjike Programin e përmendur më parë dhe për këtë qëllim duhet të bjerë dakord mbi një sistem monitorimi dhe të veprojë përkatësisht. Për referencë një kornizë logjike është bashkëngjitur tek aneksi 1 i MP-së.

Neni 6

Prokurimi, kontratat dhe procedurat e pagimit

6.1 Shërbimet e financuara nga kontributi zviceran do të prokurohen sipas procedurave standarde të KfW-së me përjashtim të menaxhimit dhe monitorimit të projektit, të cilat do t'i jepen drejtpërdrejt KfW-së dhe auditit financiar, të cilat do të prokurohen në përputhje me rregullat e prokurimit zviceran.

Neni 7

Zbatimi i projektit

7.1 Si një parim që udhëheq zbatimin e projektit, anëtarët e të gjithë organeve të përfshira gjithnjë do të përpiqen të veprojnë nën një frymë bashkëpunimi dhe të marrin vendimet me konsensus. Nëse dhe kur të jetë e nevojshme, palët kontraktuese duhet, me kërkesën e çdo pale:

a) të shkëmbejnë mendime në lidhje me kryerjen e detyrimeve të tyre përkatëse sipas MP-së, administrimin e kontributit dhe veprimet e financuara sipas kontributit;

b) t'i ofrojë palës tjetër kontraktuese të gjithë informacionin që do të kërkohet në lidhje me kryerjen e kontributit dhe të veprimeve të financuara sipas kontributit.

7.2 Palët kontraktuese do të informojnë menjëherë njëra-tjetrën për ndonjë situatë që ndërhyt ose kërcënon të ndërhyjë në përmbushjen e qëllimit të kontributit ose në performancën e secilës prej tyre, si dhe në detyrimet e tyre nën këtë MP.

7.3 Palët kontraktuese, duhet të mbajnë regjistra dhe dosje të veçanta në lidhje me zbatimin e projektit dhe përdorimin e kontributit. Ato duhet të mbajnë gjithashtu të gjitha dokumentet në lidhje me këtë MP dhe zbatimin e saj për 10 vjet pas përfundimit të projektit.

7.4 Një auditim financiar sipas politikës së auditimit financiar të SECO-s do të kryhet në fund të projektit.

7.5 Qeveria Zvicerane mund të organizojë në çdo kohë misione rishikimi për të siguruar zbatimin eficient të projektit dhe përdorimin e kontributit zviceran, si dhe arritjen e objektivave të tyre. Ajo mund të ndërmarrë, me shpenzimet e saj, një vlerësim të pavarur të projektit pas përfundimit të tij.

7.6 MPPT-ja në bashkëpunim me AZP-në, pas përfundimit të projektit, megjithatë, jo më vonë se katër muaj pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, duhet t'i japë KfW-së dhe SECO-s një raport me një objekt të tillë dhe me aq detaje sa ky i fundit arsyeshëm do t'i kërkojë, për zbatimin e projektit dhe për përmbushjen e qëllimit të kontributit zviceran.

Neni 8

Klauzola antikorrupsion

Palët kontraktuese ndajnë të njëjtin shqetësim në luftën kundër korrupsionit, i cili vë në rrezik drejtimin e mirë dhe përdorimin e duhur të burimeve të nevojshme për zhvillim dhe për më tepër rrezikon konkurrencën e drejtë dhe të hapur të bazuar në çmim dhe cilësi. Si rrjedhojë, ato deklarojnë qëllimin e tyre për të bashkuar përpjekjet e tyre për të luftuar korrupsionin, dhe, në veçanti deklarojnë që çdo ofertë, dhuratë, pagesë, shpërblim apo përfitim të çdo lloji, i dhënë nga kushdo, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me synimin për të marrë një mandat apo kontratë brenda kuadrit të kësaj MP, ose gjatë zbatimit të saj, do të përbëjë një veprim të paligjshëm ose praktikë korrupsioni. Çdo veprim i kësaj natyre përbën bazë të mjaftueshme për të arsyetuar anulimin e kësaj MP, të prokurimit ose rezultatit të shpallur nga dhënia e prokurimit, ose për të marrë ndonjë masë tjetër korrektuese të parashikuar nga legjislacioni i zbatueshëm.

Neni 9

Baza e bashkëpunimit

Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat themelore të njeriut, siç janë të përcaktuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, është baza e politikave vendore të palëve kontraktuese dhe përfituesit, dhe përfaqësojnë një element thelbësor, po aq të rëndësishëm sa edhe objektivat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

10.1 Mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin ose zbatimin e dispozitave të MP-së aktuale, të cilat nuk janë zgjidhur në mënyrë të kënaqshme me anë të negociatave zyrtare brenda një



periudhe kohe prej tre muajsh, që nga data kur ato janë ngritur nga një palë kontraktuese, me kërkesë të KfW-së në emër të SECO-s, SECO ose MPPT-ja, do të paraqiten te një gjykatë arbitrazhi të përbërë prej tre anëtarësh. KfW në emër të SECO-s ose SECO dhe MPPT do të caktojnë secila nga një arbitër. Të dy arbitrat e caktuar do të caktojnë një arbitër të tretë si kryetar, i cili do të jetë një shtetas i një vendi të tretë.

10.2 Nëse asnjë nga palët e sipërpërmendura nuk ka caktuar arbitrin e saj dhe nuk ka ndjekur ftesën e palës tjetër të përmendur më parë për të bërë caktimin e arbitrit brenda një muaji, arbitri i dytë do të caktohet me kërkesë të palës fituese nga Presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

10.3 Nëse të dy arbitrat nuk mund të bien dakord për caktimin e një arbitri të tretë (Kryetari) brenda 2 muajve pas caktimit të tyre, ky i fundit do të caktohet me kërkesën e çdo njëres nga palët e përmendura më sipër nga Presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

10.4 Nëse në rastet e specifikuar në dispozitat 10.2 dhe 10.3, Presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë pengohet për të kryer funksionin e përmendur, ose nëse ai/ajo është shtetas i ndonjëres prej palëve, caktimi do të bëhet nga Zëvendëspresidenti, dhe nëse ky i fundit ndalohet, ose nëse ai/ajo është një shtetas i ndonjëres prej palëve, caktimi do të bëhet nga Gjykatësi tjetër i lartë në Gjykatë, i cili nuk është shtetas i asnjëres prej palëve kontraktuese.

10.5 Legjislacioni i zbatueshëm është legjislacioni zviceran. Vendi i gjykatës së arbitrazhit duhet të jetë në Konfederatën Zvicerane.

10.6 Sipas dispozitave të tjera të përcaktuara nga Qeveria Zvicerane ose nga Qeveria Shqiptare, gjykata e arbitrazhit duhet të caktojë procedurën e saj.

10.7 Vendimet e gjykatës së arbitrazhit do të jenë të detyrueshme për secilën palë kontraktuese.

Neni 11

Modifikime ose ndryshime, anekset

11.1 Çdo modifikim apo ndryshim i MP-së aktuale, i bërë nga palët kontraktuese sipas kësaj MP-je, duhet të bëhet me shkrim dhe të kërkohej pëlqimi i palëve kontraktuese.

11.2 Modifikimet ose ndryshimet e anekseve të MP-së në fjalë mund të bëhen me shkrim pas konsultimeve paraprake me KfW-në në nivelin e duhur teknik me pëlqimin e SECO-s dhe MPPT-së.

Neni 12

Hyrja në fuqi dhe përfundimi

12.1 Kjo MP hyn në fuqi me përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Ajo do të qëndrojë në fuqi derisa të gjitha detyrimet e saj janë përmbushur, por jo më vonë se 31 dhjetori i 2016-ës.

12.2 Megjithatë, nëse njëra nga palët ose tjetra gjykon se, para përfundimit të MP-së në fjalë, qëllimet e saj nuk mund të arrihen më ose që pala tjetër nuk po përmbush detyrimet e saj, ajo do të ketë të drejtën të anulojë ose përfundojë MP-në në fjalë në çdo kohë, duke i dhënë një njoftim me shkrim gjashtë muaj përpara. Pavarësisht nga sa më sipër, çdo njëra nga palët, me njoftim me shkrim për arsytet, mund të përfundojë MP-në aktuale me efekt të menjëhershëm në rast të ndonjë shkeljeje të konsiderueshme të MP-së. Shkelje e konsiderueshme nënkupton çdo shkelje të rëndë të njëres prej objektivave të MP-së aktuale apo shkelje e rëndë e detyrimeve të palëve kontraktuese.

12.3 Në rast të përfundimit të MP-së në fjalë sipas nenit 12 paragrafi 2, dispozitat e MP-së

do të vazhdojnë të zbatohen për të gjitha kontratat që janë në vazhdim në kohën e përfundimit të saj derisa kontratat përkatëse të jenë përfunduar.

Neni 13
Baza ligjore

Marrëveshja kuadër dhe rregullat e prokurimit zviceran përbëjnë pjesë integrale të kësaj MP-je. Në rast mosmarrëveshjeje në përmbajtje, MP-ja aktuale do të mbizotërojë. Si shtesë, legjislacioni zviceran është i zbatueshëm.

Neni 14
Gjuha

E gjithë korrespondenca me SECO-n përfshirë çdo lloj dokumentesh, miratim faturash, raporte dhe dokumente të tjerë në lidhje me projektin do të përgatiten në anglisht.

Neni 15
Përgjegjësitë

SECO nuk merr përsipër ndonjë rrezik apo përgjegjësi për dëme, dëmtime apo efekte të tjera të mundshme të pafavorshme të shkaktuara nga projekti, përfshirë por jo vetëm të kufizuara në mospërputhjet në planifikimin e projektit, projekteve të tjera që mund të ndikojnë mbi të apo pakënaqësi të publiku.

Bërë në Tiranë më 17 nëntor 2011 në katër kopje origjinale, secila në shqip dhe gjuhën angleze. Në rast mospërputhjeje në interpretimin apo zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje projekti, teksti në gjuhën angleze do të mbizotërojë.

Për Këshillin e Ministrave
të Republikës së Shqipërisë

MINISTRI I FINANCAVE
H.E. Ridvan Bode

Lexuar dhe rënë dakord

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT

H.E. Sokol Olldashi

Për Konfederatën Zvicerane

AMBASADOR I ZVICRËS NË SHQIPËRI
H.E. Yvana Enzler

Lexuar dhe rënë dakord

Për ndërmarrjen e ujësjellës-kanalizimeve
të bashkisë së Lezhës

DREJTOR I PËRGJITHSHËM UK LEZHË
Zef Maçi



MATRIKSA E KORNIZËS LOGJIKE²

Aneksi 1

Strategjia e ndërhyrjes	Treguesit kyç të performancës	Mënyrat e verifikimit	Faktorët e jashtëm (supozimet/rreziqet)
Ndikimi	Treguesit e ndikimit		
Kushte jetese të përmirësuara për popullatën dhe kushte favorizuese për strukturën e ekonomisë vendore të Lezhës përmes rehabilitimit të sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe disa masa emergjente për rehabilitimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza.	- Zhvillimi i të ardhurave mesatare për familje - Numri i industrive dhe bizneseve të reja të hapura në Lezhë.	- Statistika të bashkisë dhe INSTAT. - Anketa për matjen e rezultateve të jetesës (LSMS)	- Kushtet socio-ekonomike të popullatës nuk janë dobësuar. - Çështjet e ujit mbahen jashtë luftërave politike. - Do të ketë subvencione për kostot e operimit dhe mirëmbajtjes (O&M) deri në zbatimin e tarifave të plota të kostove të shërbimit.
Rezultatet	Treguesit e rezultateve		
1. I njëjti nivel shërbimi me ujë të pijshëm i ofrohet një numri në rritje të konsumatorëve të bashkisë së Lezhës, duke arritur një nivel prej 94% të popullatës urbane dhe 45% të popullatës rurale.	1.1 Numri i lidhjeve të reja (0/4000) 1.2 Lidhja me sistemin qendror të furnizimit me ujë të pijshëm në zonën urbane (90%/94%) 1.3 Lidhja me sistemin qendror të furnizimit me ujë të pijshëm në zonën rurale (30%/45%)	- Raportet teknike dhe financiare të kompanisë së Ujësjetellës-Kanalizime të Lezhës. - Procesverbal i takimeve të Bordit Mbikëqyrës dhe vendimi prej Entitetit Rregullator. - Të dhëna socio-ekonomike.	- Kostot e energjisë. - Klientët pranojnë tarifat më të larta. - Klientët ose janë të gatshëm të paguajnë ose veprimet ligjore janë të suksesshme. - Lidhjet e paligjshme janë prerë ose legalizuar; zbatohen operacione efikase dhe mirëmbajtje parandaluese.
2. Furnizimi me ujë të pijshëm është i besueshëm dhe i vazhdueshëm me presionin operacional të përshtatshëm të rrjetit.	2.1 Të gjithë klientët në qendrën e qytetit kanë 24 orë ujë të pijshëm e të pastër gjatë 330 ditëve të vitit (ndryshueshmëria/min.1, max.4 masa).		- Kompania e ujësjetellës-kanalizimeve të Lezhës ka numrin e kërkuar të punonjësve me përvojë të mjaftueshme profesionale dhe arsimore. - Numër të mjaftueshëm punonjësish për leximin, vendosjen dhe mirëmbajtjen e matësve të ujit.
3. Kosto të reduktuara të operimit dhe të mirëmbajtjes, si dhe të përbalueshme duke përfshirë edhe të varfrit, kostot e ujit të pijshëm, ndërkohë që siguron mbulimin e kostove dhe rritjen e aftësisë së bashkisë për të vazhduar me rehabilitimin e sistemit të ujit të pijshëm.	3.1 Tarifat nuk kalojnë 5% të të ardhurave mesatare. 3.2 Klientë të kënaqur (2000/<1000 ankime/vit) 3.3 Të ardhurat (pa subvencione) mbulojnë kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes (58%/100%). 3.4 Humbjet komerciale janë zvogëluar (52%/40%). 3.5 Rritje në faturimin e ujit bazuar në		

² Korniza logjike përfshin komponentët e financuar nga huaja e KfW-së. Pa këto investime rezultatet dhe ndikimi i tij nuk do të ishin të arritshme.

	konsumimin e matur (47%/90%). 3.6 Mbledhje e rritur e të ardhurave (70%/80%).		
4. Cilësia e ujit të pijshëm është përmirësuar	4.1 Cilësia e ujit përmbush standardet e OBSH-së (70%/90%).		
5. Koncepti për të trajtuar situatën sanitare në Lezhë është përgatitur.	5.1 Studimi i fizibilitetit, duke përfshirë dhe buxhetin është përcaktuar.		
Output-et	Treguesit e Output-it		
<p>1. Komponentët e sistemit teknikisht operacional, sipas specifikimeve:</p> <p>a) Pusi nr. 1 është rikonstruktuar.</p> <p>b) Janë ndërtuar lidhje të reja (4000).</p> <p>c) Rezervuarët e rinj të ndërtuar (Lezhë 2000 m³) dhe/ose të rehabilituar (Balldren).</p> <p>d) Rehabilitim i rrjetit të furnizimit me ujë në qendër të Lezhës, ndërtimi i rrjetit të furnizimit me ujë në frutore dhe SMT (83 km).</p> <p>e) Ndërtimi i tubacionit kryesor të transmetimit (Balldren 5 km)</p> <p>f) Rehabilitimi i pjesëve të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza (Lezhë qendër).</p> <p>g) Instalimi i matësve të ujit në familje dhe shitjes me shumicë (4000).</p> <p>h) Sistemi SCADA, pajisjet e rrjetit, gjetja e rrjedhjeve dhe pajisja e mirëmbajtjes.</p> <p>2. Një sistem i ri i faturimit dhe i kontabilitetit i ngritur.</p> <p>3. Përshtatjet e tarifave të qëndrueshme.</p> <p>4. Fushatë për zvogëlimin e humbjeve të ujit të pijshëm dhe konsumimit të qëndrueshëm të tij.</p> <p>5. Koncepti mbi zhvillimin e punonjësve.</p> <p>6. Koncepti mbi marrëdhëniet me klientin.</p> <p>7. Studimi i fizibilitetit për kanalizimet e ujërave të zeza në Lezhë.</p>	<p>1. Masat e ndërmarra lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Planifikimin teknik - Afatet kohore - Planifikimin e kostove <p>2. Software/program i ri është funksional.</p> <p>3. Programi i tarifave të reja i përgatitur dhe i është paraqitur rregullatorit.</p> <p>4. Konsumimi i ujit për banorë i ulur (240 l/c/d³/110 l/c/d)</p> <p>5. Koncepti për zhvillimin e punonjësve i zbatuar.</p> <p>6. Koncepti për marrëdhënien me klientin i zhvilluar.</p> <p>7. Studimi i fizibilitetit i miratuar.</p>	<p>1. a-g) Raportet e progresit të projektit</p> <p>2.-5. Raportet e progresit të konsulentit</p>	<p>Rezultatet e tenderëve brenda kufirit të përlogaritjes së kostos</p> <p>Ofrimi i subvencioneve deri në mbulimin e plotë të kostove.</p>

³ Volumi i bazuar mbi prodhimin.



BUXHETI

Aneksi 3

Furnizimi me ujë të pijshëm	EUR
Rehabilitimi i rrjetit të ujit të pijshëm në qendrën e qytetit të Lezhës	6,640,000
Zgjerim i rrjetit të ujit të pijshëm në zonat e SMT-së dhe frutore, duke përfshirë lidhjet e reja të ujit me rrjetin	360,000
Zëvendësim i pusit në Barbulloja	220,000
Rezervuar i ri uji	400,000
Pajisjet mekanike, mjetet e rrjetit, pajisje për gjetjen e rrjedhjeve të ujit	150,000
Masat emergjente për kanalizimin e ujërave të zeza	
Rehabilitimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza në qendrën e qytetit të Lezhës	500,000
Shërbimet e konsulencës	
Konsulenti i planifikimit dhe zbatimit	600,000
Studimi i fizibilitetit të kanalizimeve të ujërave të zeza për higjienën publike në Lezhë	350,000
Rastësitë (10% e investimit)	780,000
Investimi total	10,000,000
Menaxhimi i projektit dhe pagesa administrative KfW (5%)	500,000
Auditim financiar i jashtëm	20,000
Kontributi total i SECO-s	10,520,000

Shënim. Një lëvizje brenda zërave të buxhetit, me përjashtim të përdorimit të shpenzimeve të paparashikuara, do të lejohet në përputhje me nenin 11, pa modifikimin e MP-së deri sa ato të mos kalojnë $\pm 25\%$.

VENDIM

Nr. 48, datë 26.1.2012

PËR KALIMIN E PRONËS “MOLI I RADHIMËS, ORIKUM”, VLORË, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË BRENDSHME, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 250, DATË 24.4.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 10, 11, 12, 13 e 14 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e pronës “Moli i Radhimës, Orikum”, Vlorë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Brendshme, për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kjo pronë “Moli i Radhimës, Orikum”, Vlorë, t’i shtohet listës së inventarit të pronave shtetërore, të miratuar e që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: MB (Njësia e lëvizshme territoriale e kufirit dhe migracionit, Vlorë)										
Bashkia/komuna: Orikum										
Fusha e përdorimit të pronës: ruajtje e kufirit detar										
Nr. rend.	A		Emërtesa e pronës vendndodhja/shtrirja gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	B			C		
	Zona kadast. Indeksi i hartës	Nr. i pasurisë			Adresa/vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e pronës në m ² ose ml	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Instituti, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1			Njësia e lëvizshme territoriale e kufirit dhe migracionit Radhimë-Vlorë		Truall	8500		Ministria e Brendshme	Njësia LTK&M Vlorë	
2				Godina kryesore zyra, fjetore, mensë-kuzhine	Pikë referimi	490		Ministria e Brendshme	Njësia LTK&M Vlorë	
3				Godina e oficerit të rojës	Jug	80		Ministria e Brendshme	Njësia LTK&M Vlorë	
4				Pikë servisi	Veri-perëndim	233		Ministria e Brendshme	Njësia LTK&M Vlorë	
5				Pikë karburanti	Veri-perëndim	12		Ministria e Brendshme	Njësia LTK&M Vlorë	
6				Kabina elektrike	Veri	10		Ministria e Brendshme	Njësia LTK&M Vlorë	

VENDIM
Nr. 49, datë 26.1.2012

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 602, DATË 24.8.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E MËNYRËS SË PËRDORIMIT TË FONDEVE KUNDËRPARTI, TË MBLEDHURA NGA GRANDET JAPONEZE PËR SEKTORIN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 602, datë 24.8.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, fjalët “... do të trajtohen si të ardhura jashtë limitit dhe do të përdoren nëpërmjet llogarisë së thesarit ...” të zëvendësohen me “... të derdhen në buxhetin e shtetit...”.
2. Pas pikës 1 të shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:



“1.1 Shuma prej 200 000 000 (dyqind milionë) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2012, artikulli 606, zëri “Transferte në buxhetet familjare”, planifikuar për skemën mbështetëse në bujqësi.”.

3. Në pikën 2, fjalët “... këto fonde të përdoren nga AZHBR-ja ...” të zëvendësohen me “... këto fonde të përdoren gjatë vitit 2012 nga AZHBR-ja ...”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 50, datë 26.1.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS RRAJCË TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të komunës Rrajcë të qarkut të Elbasanit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 133 (njëqind e tridhjetë e tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 908 (nëntëqind e tetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Rrajcë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Rrajcë

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
3-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
10-13	Prona që përdoren për realizimin funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
15-69	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave dhe objekteve të çdo lloji	Në përdorim
70-82	Varreza publike	Në pronësi

596,597,600,601,604,606, 607,608,609,611,612	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
599,603,605,623,624,628, 641,644,648,651	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproductive)	Në pronësi
657-659,661,663-830	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
837-839	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr. 62, datë 1.2.2012

PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË ÇMIMIT TË BARNAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 51 të ligjit nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit të Çmimit të Barnave, si njësi e përhershme, pranë Ministrisë së Shëndetësisë.

2. Komisioni i Çmimit të Barnave kryesohet nga drejtori i Drejtorisë Farmaceutike, në Ministrinë e Shëndetësisë, dhe ka këtë përbërje:

- | | |
|---|-------------|
| a) Drejtoria Farmaceutike, në Ministrinë e Shëndetësisë | një anëtar; |
| b) Ministria e Financave | dy anëtarë; |
| c) Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës | një anëtar; |
| ç) Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor | dy anëtarë. |

3. Sekretar i komisionit është një specialist në Drejtorinë Farmaceutike, në Ministrinë e Shëndetësisë. Titullarët e institucioneve të përmendura në këtë pikë caktojnë në detyrën e anëtarit të komisionit punonjës, që kanë lidhje me funksionin dhe detyrat e këtij komisioni.

4. Mbjajtësit e autorizimit të tregtimit të barit ose përfaqësuesi i tyre i autorizuar, përfaqësitë farmaceutike të huaja në Shqipëri, brenda datës 30 shtator të çdo viti, deklarojnë me shkresë, në zarf të mbyllur, pranë Drejtorisë Farmaceutike, në Ministrinë e Shëndetësisë, çmimet “CIF” në euro ose dollarë, për barnat e importit, dhe çmimet “EXW” (*ex-works*) në lekë, për barnat e fabrikuar në vend.

5. Drejtoria Farmaceutike njofton, zyrtarisht, mbajtësit e autorizimit të tregtimit të barit, përfaqësitë farmaceutike të huaja në Shqipëri, për dorëzimin e informacionit për çmimet, jo më vonë se dy muaj para datës 30 shtator.

6. Komisioni i Çmimit të Barnave, brenda datës 5 tetor të çdo viti, mblidhet me njoftim të kryetarit për hapjen e zarfeve të çmimeve të deklaruara, të cilat siglohen nga anëtarët e pranishëm të komisionit.

7. Komisioni i Çmimit të Barnave, brenda datës 5 nëntor, mblidhet për të shqyrtuar informacionin e përpunuar nga specialistët e çmimeve të barnave në Drejtorinë Farmaceutike, për barnat e listës që rimbursohen nga ISKSH-ja. Në këtë mbledhje, komisioni miraton çmimet që do të shpallen zyrtarisht.

8. Komisioni i Çmimit të Barnave, brenda datës 15 dhjetor, mblidhet për të shqyrtuar



informacionin e përpunuar nga specialistët e çmimeve të barnave në Drejtorinë Farmaceutike, për barnat jashtë listës së rimbursuar nga ISKSH-ja. Në këtë mbledhje, komisioni miraton çmimet që do të shpallen zyrtarisht.

9. Mbledhjet e Komisionit të Çmimit të Barnave janë të vlefshme kur në to janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Miratimi i çmimeve të barnave bëhet me votim të hapur dhe vendimi merret me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Në rast se ka barazim votash, vota e kryetarit është vendimtare.

10. Komisioni i Çmimit të Barnave, kur është e nevojshme, mbledhet me njoftim të kryetarit, për të miratuar çmimet e deklaruar për barnat që regjistrohen gjatë vitit kalendarik. Në këto raste, miratimi i çmimit të barnave bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas depozitimit të deklarimit të tyre, pranë Drejtorisë Farmaceutike.

11. Çmimet “CIF”, të deklaruar në Shqipëri, do të krahasohen me çmimet e “CIF” të shteteve referente: Itali, Greqi dhe Maqedoni. Kur mungon informacioni për çmimet “CIF” nga shtetet referente, krahasimi do të bëhet me çmimet e shitjes me pakicë të barit. Çmimet e shitjes me pakicë në Shqipëri do të krahasohen me çmimet e shitjes me pakicë të barit në shtetet referente.

12. “Çmimi i referencës për Shqipërinë” do të jetë çmimi më i ulët që aplikohet ndër tri shtetet referente.

13. Në rast se bari nuk tregtohet në asnjërin nga shtetet referente, mbajtësit e autorizimit të tregtimit të barit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, përfaqësitë farmaceutike të huaja në Shqipëri, do të vetëdeklarojnë tri çmime krahasuese “CIF” të barit nga vende të tjera ku tregtohet bari, sipas shtetit gjeografikisht më të afërt me Shqipërinë.

14. Në këtë rast “Çmimi i referencës për Shqipërinë” do të jetë mesatarja e dy çmimeve më të ulëta që aplikohen nga tri shtetet referente.

15. Informacioni për krahasimin e çmimeve të barnave do të merret nga botimet zyrtare, të publikuara nga institucionet shtetërore të vendit përkatës. Kur nuk arrihet të sigurohet informacion nga këto burime, Ministri i Shëndetësisë bashkë me Ministrin e Financave miratojnë me urdhër të përbashkët burime të tjera informacioni.

16. Komisioni i Çmimit të Barnave miraton çmimet, që nuk e kalojnë “Çmimin e referencës për Shqipërinë”. Kur çmimi i barnave, që janë alternativë e vetme, del më i lartë se “Çmimi i referencës për Shqipërinë” bëhet negociim për uljen e çmimit.

17. Nga ky rregull bëjnë përjashtim çmimet e miratuara për vitin 2012, për të cilat, kur janë më të larta se “Çmimi i referencës për Shqipërinë”, negociohet për uljen e çmimit.

18. Barnat, për të cilat nuk është deklaruar çmim ose nuk janë regjistruar deri më 30 nëntor të vitit aktual, humbasin të drejtën për t’u futur në listën e barnave të rimbursuara për vitin pasardhës. Bëhet përjashtim vetëm për barnat që janë alternativa të vetme në treg dhe barnat që janë në proces reregjistrimi.

19. Drejtoria Farmaceutike, brenda datës 25 dhjetor të çdo viti, bën shpalljen në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë së listës së përgjithshme me çmimet “CIF”, përveç barnave që janë në proces negociimi. Kjo listë u njoftohet zyrtarisht Qendrës Kombëtare të Kontrollit të Barnave, Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

20. Kundër vendimit të Komisionit të Çmimit të Barnave, subjektet kanë të drejtën e ankimit te Ministri i Shëndetësisë, brenda 10 (dhjetë) ditësh nga data e marrjes së vendimit. Kundër vendimit përfundimtar bëhet ankim në gjykatë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit.

21. Anëtarët e komisionit, për çdo mbledhje, shpërblehen me 5 000 (pesë mijë) lekë, nga fondet buxhetore, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë.

22. Brenda 30 (tridhjetë) ditësh pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, Ministri i Shëndetësisë

dhe Ministri i Financave miratojnë rregulloren për metodologjinë dhe mënyrën e administrimit të çmimeve të deklaruara, e cila do të ndiqet për caktimin e çmimeve të barnave.

23. Vendimi nr. 504, datë 7.7.2007 i Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Çmimit të Barnave”, shfuqizohet.

24. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr. 3, datë 31.1.2012

PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 20, DATË 10.10.2007 “PËR MODELET E LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, udhëzimit nr. 15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 20, datë 10.10.2007 “Për modelet e licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Certifikatat për veprimtarinë e transportit të udhëtarëve për llogari të vet brenda vendit me autobus, do të jenë sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi”.

2. Në pikën 4, pas tabelës 2 bëhet shtesa e mëposhtme:

“Modeli nr. 215; Emërtimi: Certifikatë për transportin e udhëtarëve për llogari të vet brenda vendit; Ngjyra e verdhë; Simboli i bashkisë ose komunës që e lëshon”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi



(Faqja e parë e certifikatës)
(Letër ngjyrë të verdhë-format A4)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Simboli i bashkisë/komunës

BASHKIA/KOMUNA _____

CERTIFIKATË

Nr. _____, datë ___/___/___

PËR TRANSPORTIN E UDHËTARËVE PËR LLOGARI TË VET BRENDA VENDIT

I LËSHOHET AUTOBUSIT:

Targa:

Marka:

Në përdorim të ndërmarrjes (personit fizik/juridik):.....

NIPT/kodi fiskal:.....

Kjo certifikatë siguron që:

- shërbimi i transportit është për qëllime jotregtare dhe jofitimprurëse për ndërmarrjen;
- veprimtaria e transportit është vetëm një veprimtari ndihmëse për ndërmarrjen;
- mjetet e përdorura janë pronë e ndërmarrjes, ose të blera me këste prej saj, ose janë objekt i një kontrate qiramarrje afatgjatë;
- autobusi drejtohet nga një punonjës apo anëtar i ndërmarrjes.

Certifikata është e vlefshme deri më datën ___/___/___

Firma dhe vula
e autoritetit kompetent

(Faqja e pasme e certifikatës)

Dispozita të përgjithshme

1. Kjo certifikatë lejon kryerjen e transportit të udhëtarëve me autobus për llogari të vet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Transportet e udhëtarëve për llogari të vet janë transportet e kryera për qëllime jotregtare dhe jofitimprurëse nga një ndërmarrje, me kusht që:
 - veprimtaria e transportit është vetëm një veprimtari ndihmëse për ndërmarrjen;
 - mjetet e përdorura janë pronë e ndërmarrjes, ose janë të blera me këste prej saj, ose janë objekt i një kontrate qiramarrjeje afatgjatë dhe drejtohen nga një punonjës apo anëtar i ndërmarrjes.
3. Transporti i udhëtarëve për llogari të vet i nënshtrohet kontrollit të dokumentacionit mbi plotësimin e kushteve të pikës 2 më sipër për kryerjen e transportit të udhëtarëve.
4. Certifikata mbahet në original në mjet gjatë gjithë kohës së udhëtimit dhe i paraqitet organeve të kontrollit me kërkesën e tyre.
5. Në rast të ndërrimit, zëvendësimit, shitjes ose dhënies me qira të mjetit ose kur mjeti del jashtë përdorimit, ose kur subjekti pezullon/mbyll veprimtarinë, është i detyruar të dorëzojë certifikatën origjinale të mjetit në zyrën e licencave, e cila e ka lëshuar atë.
6. Certifikata nuk mund të transferohet nga mbajtësi i saj te një subjekt tjetër.

URDHËR

Nr. 34, datë 31.1.2012

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, MASTER
PROFESIONAL NË “ADMINISTRIM PUBLIK”, PRANË SHKOLLËS SË LARTË
UNIVERSITARE JOPUBLIKE “GJON BUZUKU” SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 42/1 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen, në përputhje me vendimin nr. 288, datë 20.12.2011 të Këshillit të Akreditimit, në shkollën e lartë universitare jopublike “Gjon Buzuku” Shkodër, e programit të studimit “Master profesional” në:
 - a) Administrim Publik.
2. Programet e studimit të ciklit të dytë të përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri realizohen me 90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1.5 vite akademike. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet diplomë universitare “Master profesional” në fushën e arsimit të kryer.
3. Këto programe studimi fillojnë veprimtarinë akademike në vitin akademik 2011-2012.
4. Shkolla e lartë universitare jopublike “Gjon Buzuku” Shkodër duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.



5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij urdhri.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë jopublike “Gjon Buzuku”, Shkodër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr. 37, datë 2.2.2012

**PËR RIORGANIZIMIN E NJËSIVE KRYESORE TË SHKOLLËS SË LARTË
UNIVERSITARE PRIVATE “MEDIKADENT”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, pikave 5 dhe 6 të nenit 41 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 674, datë 27.9.2006 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, private “Medikadent”,

URDHËROJ:

1. Riorganizimin e njësive kryesore të shkollës së lartë universitare private “Medikadent”, në përputhje me vendimin nr. 294, datë 20.12.2011 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë “Për riorganizimin e institucional të shkollës së lartë universitare private “Medikadent”, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Struktura e re e shkollës së lartë universitare private “Medikadent” të jetë:

a) Fakulteti i Infermierisë;

b) Fakulteti i Shkencave Mjekësore të Aplikuara.

3. Fakulteti i Infermierisë të ketë në përbërje këto njësi bazë:

i) Departamenti i lëndëve bazë;

ii) Departamenti i lëndëve klinike;

iii) Qendra e kujdesit infermieror.

4. Fakulteti i Shkencave Mjekësore të Aplikuara të ketë në përbërje këto njësi bazë:

i) Departamenti i Metodikave Laboratorike;

ii) Departamenti i Specialiteteve;

iii) Qendra e Shërbimeve Protetike-Dentare.

5. Ky institucion duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë universitare private “Medikadent”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr. 38, datë 2.2.2012

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT PRANË INSTITUCIONIT
PRIVAT “SHKOLLA E LARTË NDËRKOMBËTARE E TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenit 44/1 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 18.3.2009 “Për licencimin e institucionit privat “Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës”,

URDHËROJ:

1. Hapjen pranë institucionit privat “Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës”, të programit të ri të studimit të ciklit të parë në “Psikologji”, që realizohet me 180 kredite, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në “Psikologji”.

2. Hapjen pranë institucionit privat “Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës”, të programit të ri të studimit të ciklit të dytë “Master profesional” në “Shkenca edukimi”, që realizohet me 90 kredite, me kohëzgjatje normale 1.5 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master profesional” në “Shkenca edukimi”.

3. Hapjen pranë institucionit privat “Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës”, të programit të ri të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Shkenca edukimi”, që realizohet me 120 kredite, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë dhe në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” në “Shkenca edukimi”.

4. Këto programe studimi hapen në bazë të vendimit nr. 271, datë 4.11.2011 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.

5. Programet e studimit të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij urdhri, fillojnë veprimtarinë akademike në vitin akademik 2011-2012.

6. Institucioni privat “Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës”, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij urdhri.

8. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe institucioni privat “Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj



VENDIM
Nr. 7, datë 24.1.2012

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
ME NR. 4168 PROT., DATË 30.12.2011 MIDIS OST SHA DHE “RUDNAP ENERGY
TIRANA” SHPK**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës “V” të rregullave të tregut shqiptar të energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, pikës 4.13 germa “A” pika 3, pikës 7 germa “g” të “Modelit të tregut të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.1.2012, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s dhe marrëveshjen e transmetimit të energjisë elektrike me nr. 4168 prot., datë 30.12.2011, midis OST sh.a. dhe Rudnap Energy Tirana sh.p.k.,

konstatoi se:

- Palët e kësaj kontrate OST sh.a. dhe “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k., janë subjekte të licencuara nga ERE respektivisht me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 24, datë 26.3.2009 për aktivitetin e transmetimit dhe vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 20, datë 4.3.2011 për aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar.

- Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me “Modelin e tregut të energjisë”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, rregullat e tregut të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar, si dhe me vendimin e ERE-s nr. 146, datë 7.12.2011 “Për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a., për periudhën e tretë rregullatore”.

- Modeli i tregut vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë natyrë kontrate.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes së transmetimit të energjisë elektrike me nr. 4168 prot., datë 30.12.2011, midis OST sh.a. dhe “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k., me ndryshimet si më poshtë:

Pikat 5.13 dhe 5.14 përpunohen si më poshtë:

“Pika 5.13

Në rast kur “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k. nuk ka kontestime në lidhje me faturën, por vonon në kryerjen e pagesave ndaj OST sh.a., ajo do të paguajë një kamatëvonesë mbi vlerën e faturës siç përcaktohet në pikën 5.14.

Pika 5.14

Pas kalimit të afatit të pagesës së caktuar në pikën 5.8 të kësaj marrëveshjeje, “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k. është e detyruar t’i paguajë OST sh.a., një kamatëvonesë të barabartë me 120% të shkallës së interesit ndërbankar të Bankës së Shqipërisë, që përcaktohet çdo tremujor, në bazë të shkallës mesatare të tremujorit paraardhës.”

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrotjtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 8, datë 24.1.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “HYDRO
SALILLARI” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9, dhe nenit 45 pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “f”, dhe 10 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108 datë 9.9.2008, nenit 18 pikat 1 germa “a” dhe 3 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerve, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.1.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hydro Salillari” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hydro Salillari” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipërcituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Hydro Salillari” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



VENDIM
Nr. 9, datë 24.1.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“HYDRO SALILLARI” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR
“HEC VERTOP” SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa “d” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar dhe neneve 7 dhe 8 të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 24.1.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hydro Salillari” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues për “Hec Vertop” si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hydro Salillari” sh.p.k. është konform “Rregullave të procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7 pika 2 gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj. Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3 gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Hydro Salillari” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues për “Hec Vertop” si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 10, datë 25.1.2012

**MBI ANKIMIN ADMINISTRATIV TË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA NË LIDHJE ME
VENDIMIN NR. 147, DATË 7.12.2011 “PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PERIUdhËN E TRETË
RREGULLATORE” DHE VENDIMIN NR. 148, DATË 7.12.2011 “PËR PËRCAKTIMIN E
ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR
KONSUMATORËT TARIFORË PËR PERIUdhËN E TRETË RREGULLATORE” TË
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S**

Në mbështetje të nenit 9 pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 16 dhe 16/1 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, të ndryshuara, nenit 25 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 328 të Kodit të Procedurës Civile, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 25.1.2012, pasi analizoi ankimin e paraqitur nga “CEZ shpërndarje” sh.a., me shkresën nr. 7125/1, datë 26.12.2011, si dhe relacionin e përgatitur nga grupi i punës dhe opinionin e Panelit Rishikues, të krijuar sipas procedurave të parashikuara në marrëveshjen e mbështetjes qeveritare të miratuar me ligjin nr. 10 126, datë 11.5.2009 “Për miratimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për Garantimin e Projektit të Privatizimit të OSSH sh.a.”,

konstatoi se:

- Në ankimin e “CEZ shpërndarje” sh.a., janë paraqitur në cilësinë e provave të reja rillogaritjet e Bazës së Rregulluar të Aseteve, të dhënat aktuale të raportimit të 11 mujorit 2011, si dhe gabimet matematikore përkatëse;

-Të dhënat shtesë të “CEZ shpërndarje” sh.a., Rekomandimet e Panelit rishikues dhe argumentimet e grupit të punës të ERE-s që shqyrtoi këtë ankim dhe rillogaritjet dhe axhustimet përkatëse nuk sjellin asnjë ndryshim në të ardhurat e kërkuara të kompanisë “CEZ shpërndarje” për periudhën e tretë rregullatore

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë shqyrtimin e kërkesës së “CEZ shpërndarje” sh.a., për rishikim të vendimeve të ERE-s nr. 147, datë 7.12.2011 “Për përcaktimin e tarifës të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore” dhe vendimin nr. 148, datë 7.12.2011 “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën e tretë rregullatore” sipas shkresës së “CEZ shpërndarje” sh.a., me nr. 7125/1, datë 26.12.2011.

2. Lënien në fuqi të vendimeve nr. 147, datë 7.12.2011 “Për përcaktimin e tarifës të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore” dhe vendimin nr. 148, datë 7.12.2011 “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën e tretë rregullatore” të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

3. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë “CEZ shpërndarje” sh.a., për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



VENDIM
Nr. 11, datë 6.2.2012

**PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME
SERI PV10K, NR. 104, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË
ERE-S NR. 51 DATË 5.7.2010 PËR SHOQËRINË “WENERG” SHA**

Në mbështetje të nenit 9 dhe 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe neneve 10, 15 pikat 1 dhe 2 germa “b”, pika 4 germa “a” dhe “b” të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.2.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Wenerg” sh.a., për ndryshimin e licencës nr. 104, seria PV10K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 51, datë 5.7.2010 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Wenerg” sh.a. plotëson kërkesat ligjore siç kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15 pika 4 germa “a”: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës.

- Neni 15 pika 4 germa “b”: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën me nr. 104, seria PV10K, për prodhimin e energjisë elektrike nga hec “Dardha 1” me fuqi 4 MW, të shoqërisë “Wenerg” sh.a., të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 51, datë 5.7.2010.

2. Fuqia e instaluar e hec “Dardha 1” nga 4 MW të bëhet 5.8 MW.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 12, datë 6.2.2012

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SNOW ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE NGA HEC “KOKA 1”**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, neneve 4, pika 1 germa “a”, 5 pika 1 germa “a”, 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.2.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Snow Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Snow Energy” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Snow Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Koka 1”, me fuqi 3.2 MW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



VENDIM
Nr. 13, datë 6.2.2012

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SNOW ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, 9 dhe 13, pika 1 germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, neneve 4, pika 1 germa “g”, 5, pika 2, 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.2.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Snow Energy” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe të licencuarve të Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Snow Energy” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “f” dhe “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Snow Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 14, datë 6.2.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HYDRO POWER PLANT OF KORCA” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “VERBA 1” DHE “VERBA 2”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13, pika 1 germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108 datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1, germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.2.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hydro Power Plant of Korca” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hydro Power Plant of Korca” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave” si më poshtë:

- Formatimi i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Hydro Power Plant of Korca” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et “Verba 1 dhe “Verba 2”.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



VENDIM
Nr. 15, datë 6.2.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBANIA
POWER” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE NGA
HEC MARTANESH**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13, pika 1 germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa “a” dhe nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108 datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.2.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albanian Power” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Albanian Power” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Albanian Power” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Martanesh”.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 9, datë 27.1.2012

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR KL-ED”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat kabllor “TV kabllor KL-ED”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore kabllore.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet nga data 14.10.2011 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr. 10, datë 27.1.2012

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO AS”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor “Radio AS”, në fushën e transmetimeve radiofonike private vendore.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet nga data 7.11.2011 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati



VENDIM
Nr. 11, datë 27.1.2012

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO IDEA”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Idea”, në fushën e transmetimeve radiofonike private vendore.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet nga data 5.8.2011 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr. 13, datë 27.1.2012

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“TV BAJRAM CURRI”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat vendor “TV Bajram Curri”, në fushën e transmetimeve televizive private vendore.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet nga data 9.11.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr. 14, datë 27.1.2012

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“TV ERA”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat vendor “TV Era”, në fushën e transmetimeve televizive private vendore.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet nga data 13.12.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 24.2.2012
Doli nga shtypi më 27.2.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 40 lekë